



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

SENATI

Ref.

Datë:

UDHËZUES PËR STUDENTËT E RINJË

Dhjetor, 2019

PËRMBATJA

QËLLIMI I UDHËZUESIT.....	3
HISTORIKU I UNIVERSITETIT “HAXHI ZEKA” NË PEJË.....	3
NJËSITË AKADEMIKE NË UNIVERSITETIN “HAXHI ZEKA” NË PEJË	6
KUSHTET E REGJISTRIMIT NË STUDIMET BACHELOR	7
KUSHTET E REGJISTRIMIT NË STUDIMET MASTER.....	7
KOHËZGJATJA E STUDIMEVE.....	8
ORGANIZIMI I LIGJËRATAVE, USHTRIMEVE DHE PRAKTIKAVE PROFESIONALE	9
PROCESI I VLERËSIMIT.....	9
KUSHTET E REGJISTRIMIT TË VITIT VIJUES TË STUDIMEVE	10
NDRYSHIMI I STATUSIT TË STUDENTIT ME KORRESPONDENCË NË TË RREGULLT	10
NDËRRIMI I DREJTIMIT TË STUDIMEVE.....	11
NDËRPRERJA DHE HUMBJA E STATUSIT STUDENT	11
PËRFUNDIMI I STUDIMEVE DHE MBROJTJA E PROVIMIT PËRFUNDIMTAR (MBROJTJA E DIPLOMËS). 12	
KRITERETET PËR NDARJEN E BURSAVE	13
LIRIMI NGA PEGESA E SEMESTRIT PËR STUDENTËT QË I TAKOJNË KATEGORIVE TË VEÇANTA.....	13
ORGANIZIMI I STUDENTËVE.....	14
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTËVE	15
QENDRA PËR ZHVILLIM TË KARRIERËS.....	17
BIBLIOTEKA.....	20

Duke u bazuar në Statutin e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, Rregulloren për studime bachelor dhe master, Rregulloren për ndarjen e bursave të UHZ-së, Udhëzimi Administrativ 17/2014 për pagesat e studentëve në universitetet publike, Ligjin Nr.04/L-054 dhe Ligjin Nr.04/L-261, është hartuar Udhëzuesi për Studentët e Rinjë.

QËLLIMI

Ky udhëzues ka për qëllim të informojë studentët e rinjë dhe kandidatët potencial për student të UHZ-së në të gjitha nivelet e studimit, lidhur me funksionimin dhe organizimin e UHZ-së, të drejtave dhe detyrimet e tyre dhe mundësitë për zhvillim të karrierës.

UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA” NË PEJË

Universiteti Publik “Haxhi Zeka” në Pejë, u themelua si Universitet i pavarur në vitin 2012 dhe ishte vazhdimësi e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në Biznes (FSHAB) në Pejë.

FSHAB u themelua në vitin 1960 me vendimin e Këshillit Ekzekutiv të KSAK si “Shkolla e Lartë Ekonomike – Komerciale” në Pejë e cila fillimisht kishte vetëm seksionin e Afarizmit Komercial në Ndërmarrje dhe në fillet e saja kishte numër të kufizuar të mësimeve dhe studentëve. Veprimtaria dhe zhvillimi i “Shkollës së Lartë Ekonomike” u orientua në ndërtimin e planprograme të studimeve të rregullta që i përgjigjeshin kushteve ekonomiko shoqërore dhe nevojave të zhvillimit ekonomik të kohës. Në këtë mënyrë, u mundësoi mijëra studentëve nga të gjitha trojet shqiptare që të kryenin studimet dhe të avancojnë në karrierën e tyre.

“Shkolla e Lartë Ekonomike” në Pejë përjetoi disa periudha kohore mjaft interesante dhe të rëndësishme ekzistenciale. Si ato të:

1960-1974 – periudha e formimit dhe e krijimit të identitetit institucional;

1975- 1990 – periudha e afirmimit të shkollës në Kosovë dhe në të gjitha vendet tjera përreth Kosovës;

1991-1999 – periudha e mbijetesës, me anë të vazhimit të kontinuitetit nëpërmes organizimit paralel të mësimit nëpër shtëpi private;

2000 – 2006 – periudha e riorganizimit të FSHAB-së.

“Shkolla e Lartë Ekonomike” u reformua sipas modelit të Deklaratës së Bolonjës dhe u riemërua “Shkolla e Biznesit” ku studimet zhvilloheshin në tri departamente: Administrim Biznesi, Informatikë e Aplikuar në Biznes dhe Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri. Në vitin 2002 organizohen studime në gjuhën boshnjake në departamentin Administrim Biznesi.

Nga viti 2004 FSHAB emërtohet “Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit”. Që nga viti 2007 në FSHAB studimet i zhvilloi në tri departamente: departamenti Administrim Biznesi në të dy gjuhët (shqipe dhe boshnjake); departamenti Kontabilitet dhe Financa të Biznesit; dhe departamenti Menaxhment Turizëm dhe Hotelieri. Në mars të vitit 2009 FSHAB u akreditua nga Agjencioni për Akreditim në të gjitha planprogramet. Studimet e rregullta dhe ato me korrespondencë në Fakultetin e Biznesit të Aplikuara në Pejë ofronin përgatitjen akademike Bachelor i shkencës dhe Master.

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë është themeluar duke u bazuar në nenin 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Administratë Shtetërore të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Arsimin e Lartë (Gazeta Zyrtare nr.14.9, shtator 2011) - VENDIM – Themelohet Universiteti Publik "Haxhi Zeka" në Pejë si institucion arsimor dhe i kërkimit e shkencës, i cili jep diploma e grada shkencore deri në nivelin e doktoraturës. Obligohen organet e MASHT, që të bëjnë të gjitha përgatitjet e nevojshme për themelimin dhe funksionalizimin e Universitetit Publik "Haxhi Zeka".

Universiteti "Haxhi Zeka" në përbërjen e vet ka këto fakultete:


- Fakulteti i Biznesit;
- Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis;
- Fakulteti Juridik;
- Fakulteti i Agrobiznesit;
- Fakulteti i Arteve.

Universiteti "Haxhi Zeka" ka marrëdhënie bashkëpunimi me të gjitha institucionet shtetërore dhe ndërkombëtare që operojnë në Republikën e Kosovës. Universiteti "Haxhi Zeka" gjithashtu ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë në nivel rajonal dhe ndërkombëtar ku deri më tani ka arritur të lidhë mbi 43 marrëveshje bashkëpunimi në fusha të ndryshme.

Universiteti "Haxhi Zeka" synon që përmes planit afatgjatë do të krijojë profil të ri në fushën e veprimtarisë akademike dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në mënyrë që të kontribuojë sa më shumë drejt ndërkombëtarizimit të mëtutjeshëm. Në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, aktualisht vijojnë studimet 11.254 studentë, në këtë institucion nga viti akademik 2012/2013 deri më tani në vitin akademik 2018/2019 kanë përfunduar studimet në të gjitha njësitë akademike 4.455 studentë.

Shënim: është vendosur historiku i përditësuar.

Organogrami



NJËSITË AKADEMIKE NË UNIVERSITETIN "HAXHI ZEKA" NË PEJË

FAKULTETI I BIZNESIT

Programet e studimit

• Administrim Biznesi, BA, 180 ECTS - 30/09/2019
• Administrim Biznesi (Gjuhë Boshnjake), BA, 180 ECTS, 30/09/2019
• Kontabilitet dhe Financa, BA, 180 ECTS, 30/09/2019
• Administrim Biznesi (Gjuhë Boshnjake), MA, 120 ECTS, 30/09/2019
• Kontabilitet dhe Financa, MA, 120 ECTS, 30/09/2019
• Menaxhim i Burimeve Njerëzore, MSc, 120 ECTS, 30/09/2021

FAKULTETI JURIDIK

Programet e studimit

• Juridik i Përgjithshëm, LLB, 240 ECTS - 30/09/2019
• Juridiko Penal, LLM, 60ECTS - 30/09/2019

Programi i përbashkët

• Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike, MSc, 120 ECTS - 30/09/2020

FAKULTETI I MENAXHMENTIT NË TURIZËM, HOTELERI DHE MJEDIS

Programet e studimit

• Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri, BA, 180 ECTS - 30/09/2019
• Menaxhment në Turizëm (Gjuhë Boshnjake), BA, 180 ECTS - 9/30/2022

FAKULTETI I AGROBIZNESIT

Programet e studimit

• Teknologji e Prodhimit Bimor, BSc, 180 ECTS - 30/09/2019
• Agromjedis dhe Agroekologji, BSc, 180 ECTS - 30/09/2019
• Teknologji Ushqimore, BSc, 180 ECTS - 30/09/2019

FAKULTETI I ARTEVE

Programet e studimit

• Edukim në Muzikë, Bachelor Professional, 240 ECTS - 9/30/2020
• Edukim i Përgjithshëm në Muzikë, Bachelor Professional, 240 ECTS - 9/30/2020
• Edukim Artistik në Instrumente Frymore, BMus, 240 ECTS - 30/09/2019

Shënim: vendosen programet e reja të cilat akreditohen në secilën njësi akademike.

KUSHTET E REGJISTRIMIT NË STUDIMET BACHELOR

Kandidatët e interesuar për pranim dhe regjistrim në ciklin e parë të studimeve që organizohen nga njësiti akademike në UHZ, duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të kenë të përfunduar shkollën e mesme dhe të kenë kaluar provimin shtetëror të maturës, si dhe kandidatët të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme të vërtetuar me diplomë (gjeneratat pa provim shtetëror të maturës).
- Të kenë përfunduar me sukses shkollën fillore dhe të mesme më së paku 12 vjet të shkollimit (të vërtetuar me diplomë përkatëse).
- Të kenë të nostrifikuar dhe të vërtetuar diplomën e fituar të shkollimit të mesëm jashtë Republikës së Kosovës, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës.

Konkurimi, pranimi dhe regjistrimi i studentëve të rinj, bëhet në pajtim me kushtet e parapara me konkurs të cilin e shpall dhe publikon Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë.

Kandidati fiton të drejtën për pranim dhe regjistrim kur e kalon provimin pranues me sukses duke u bazuar në numrin e pikëve të fituara sipas ranglistës deri në numrin e përcaktuar për pranim në programin përkatësisht ose drejtimin përkatës mësimit.

Kushtet, afatet, organizimi dhe mënyra e mbajtjes së provimit pranues përcaktohen detajisht në konkursin të cilin e publikon Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë.

Kandidatët, të cilët konkurojnë në konkurs për pranim, janë të detyruar:

- Të aplikojnë online përmes ëeb-faqes së Universitetit
- Të sjellin diplomën bashkë me dëftesat e shkollës së mesme (në origjinal), çertifikatën e lindjes dhe kopjen e letërnjoftimit,
- Të bëjnë pagesën për provimin pranues, nëse nuk parashihet ndryshe me konkurs.

Dokumentacioni dorëzohet tek zyrtari kompetent për çështje të studentëve.

KUSHTET E REGJISTRIMIT NË STUDIMET MASTER

Studentët në studime Master pranohen mbi bazën e konkurrimit, sipas rezultateve të studimeve paraprake dhe ekuivalencës së tyre, sikurse përcaktohet në Ligjin për Arsimin e Lartë.

Kriteret e posaçme për pranim në studimet master do të caktohen nga Senati në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

Studimet dyvjeçare postdiplomike-(studimet master), kanë të drejtë t'i regjistrojnë studentët të cilët kanë kryer studimet themelore (studimet bachelor), të drejtimit përkatës dhe që kanë fituar së paku 180 ECTS kredi.

Studimet njëvjeçare postdiplomike-(studimet master), kanë të drejtë t'i regjistrojnë të gjithë studentët që kanë përfunduar studimet themelore katër vjeçare të drejtimit përkatës dhe kanë fituar së paku 240 ECTS kredi, sipas kushteve dhe plan-programeve të Departamenteve përkatëse të njësive akademike të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

Në studimet master kanë të drejtë të regjistrohen edhe kandidatët të cilët studimet themelore i kanë kryer jashtë vendit e të cilat njihen nga EUA (Shoqata e Universiteteve Evropiane), ose institucioni i cili është pranuar nga një agjensi ndërkombëtare e akreditimit.

Ekuivalenteimi dhe nostrifikimi i certifikatave-diplomave të jashtme e bën Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në bazë të ligjit dhe rregulloreve përkatëse.

Përzgjedhja e kandidatëve

Përzgjedhjen e kandidatëve për studime master e bën Komisioni përkatës më së paku 3 anëtarë, të cilin e zgjedh Këshilli i Fakultetit.

Komisioni duhet të jetë kompetent dhe profesional sipas lëmisë së studimeve. Komisioni në bashkëpunim me Dekanatin e Fakultetit e shpall ranglistën e kandidatëve që kanë aplikuar, kanë hyrë në provim pranues dhe janë pranuar.

Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në studimet master të cilët pretendojnë në ndonjë shkëlqje eventuale, mund të ushtrojnë ankesë me shkrim drejtuar Dekanatis brenda dy ditëve të punës nga dita e publikimit të rezultatit.

Vendimi mbi ankesat e ushtruara merret në afatin prej dy ditëve pune pas ushtrimit të ankesës.

Regjistrimi i studentëve në semesrin e parë në studimet master bëhet në Administratën Qendrore të UHZ.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

Me rastin e konkurimit kandidatët duhet të sjellin këto dokumente:

- Çertifikatën e lindjes
- Diplomën (çertifikatën) e kryerjes së fakultetit (kopja e noterizuar)
- Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.

Kandidatët e pranuar për regjistrim paraqesin:

- Fletëregjistrimin e plotësuar i cili mirret me rastin e regjistrimit
- Një fotografi (formati 4.5 x6cm)
- Pagesën në lartësi të përcaktuar nga Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë.

Dokumentet e dorëzuara nga studenti me rastin e regjistrimit mbeten në shërbimin e studentëve. Shërbimi i studentëve bën regjistrimin e studentëve të rinjë në librin amzë, në programin e veçantë në kompjuter dhe formon dosjen e studentit.

KOHËZGJATJA E STUDIMEVE

Niveli Bachelor

Në Fakultetet e Universitetit "Haxhi Zeka" - Pejë, studimet themelore zgjasin:

- Në sistemin 3 vjeçarë zgjasin 6 semestra dhe kërkojnë që të plotësojnë së paku 180 ECTS kredi deri në përfundimin e studimeve.
- Në sistemin 4 vjeçarë zgjasin 8 semestra dhe kërkojnë që të plotësohen së paku 240 ECTS kredi deri në përfundim të studimeve.

Studenti duhet t'i sigurojë për çdo vit të studimeve nga 60 ECTS kredi nga provimet e dhëna në lëndët obligative dhe zgjedhore.

Niveli Master

Studimet master varësisht nga akreditimi dhe programet studimore në njësitë e ndryshme akademike të UHZ zgjasin një vit (dy semestra), përkatësisht 2 vite (4 semestra) dhe në çdo semestër me dhënie e provimeve fitohen nga 30 ECTS, që do të thotë për përfundimin e këtyre studimeve duhet të arrihen 60 përkatësisht 120 kredi të ECTS. Pas përfundimit të semestrit të fundit të rregullt të studimeve bachelor dhe master, studentit duhet t'i përcaktohet një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajve për t'i përfunduar provimet (periudha e diplomimit). Studenti mund të kërkojë një herë nga Dekani i njësisë akademike për vazhdimin e periudhës së diplomimit edhe për dymbëdhjetë (12) muaj të tjerë. Fillimi dhe mbarimi i semestrave mësimor bëhet sipas dispozitave statutore. Mësimi në studimet master zhvillohet në 15 javë për një semestër.



ORGANIZIMI I LIGJËRATAVE, USHTRIMEVE DHE PRAKTIKAVE PROFESIONALE

Universiteti organizon studimet në pajtim me programet ekzistuese të studimit gjatë vitit akademik i cili zgjat dymbëdhjetë (12) muaj. Viti akademik fillon më 1 tetor dhe mbaron më 30 shtator.

Periudha aktive e studimeve (ligjëratat, ushtrimet, seminarët, kolokiumet) është e ndarë në dy semestra. Semestri dimëror që fillon më 1 tetor dhe mbaron më 15 janar. Semestri veror që fillon më 16 shkurt dhe mbaron më 31 maj.

Lënda mund të ligjërohet me javë (pesëmbëdhjetë (15) javë semestri) gjatë një (1) apo dy (2) semestrave ose mund të mbahet si bllok ligjëratash në një semestër.

Kalendari i studimeve nxirret nga Senati më së voni deri më 31 maj dhe përmban orarin e ligjëratave (ligjëratat, ushtrimet, seminarët, kolokiumet), kushtet dhe afatet e provimit.



Studentët janë të detyruar që në bazë të plan-programit mësimor të njësisë përkatëse akademike, të mbajnë mësimin praktik, ushtrimet përkatësisht praktikën profesionale. Universiteti në bazë të marrëveshjeve do të mundësojë për studentët kryerjen e punës praktike për lëndët që ndëgjojnë.

PROCESI I VLERËSIMIT

Vlerësimi i progresit të studentëve bëhet me notë. Në fillim të semestrit, mësimdhënësit duhet t'ju dorëzojnë studentëve plan programin (syllabusin) e lëndës, i cili përmban përshkrim të shkurtër të lëndës, qëllimet dhe rezultatet e mësimin të kësaj lënde, si edhe metodën e vlerësimit dhe notimit. Syllabusi, përveç tjerave përshkruan edhe aktivitetet që do të zhvillohen gjatë orës mësimore dhe datat e mbajtjes së kolokiumit dhe provimit përfundimtar. Provimet vlerësohen nga një pyetës (mësimdhënës/profesor) ose me komision.

AFATET E RRUGULLTA TE PROVIMEVE

- AFATI I JANARIT
- AFATI I QERSHORIT
- AFATI I SHTATORIT

Vlerësimi i provimit shprehet me notë:

- Nota 10 dhe 9 - shprehin sukses të shkëlqyeshëm;
- Nota 8 - shprehë sukses shumë të mirë;
- Nota 7 - shprehë sukses të mirë;

- Nota 6 - shprehë sukses të mjaftueshëm;
- Nota 5 - shprehë sukses të pa mjaftueshëm (dobët).

Studenti vlerësohet mbetës në lëndën përkatëse kur:

Tërhiqet nga provimi;

Kopjon;

Mashtron me mjete ndihmëse jo të lejueshme (në këtë rast ai nxirret jashtë provimit), dhe do të jetë subjekt i procedurave disiplinore.

Studenti ka të drejtë të parashtrojë ankesë me shkrim kundër notës së marrë në provim si dhe të kërkojë shikimin e testit të dorëzuar dhe të vlerësohet nga pyetësi (profesori) apo nga Komisioni, Ankesa duhet të parashtrohet brenda 24 orësh, pasi të jenë shpallur rezultatet e provimit.

Dekani e cakton komisionin prej tre anëtarësh për organizimin e provimit. Në komisionin e caktuar nuk merr pjesë pyetësi (profesori) i mëparshëm. Studenti nuk ka të drejtë të paraqet ankesë kundër vlerësimit të komisionit.

KUSHTET E REGJISTRIMIT TË VITIT VIJUES TË STUDIMEVE

Studenti ka të drejtë të regjistrojë vitin e dytë të studimeve, nëse ka akumuluar minimumi 42 ECTS kredi nga numri i përgjithshëm i kredive nga lëndët mësimore të vitit të parë të studimeve.

Vitin e tretë të studimeve, studenti mund të e regjistrojë nëse ka akumuluar minimumi 36 ECTS kredi nga numri i përgjithshëm i kredive nga lëndët mësimore të vitit të dytë të studimeve.

Vitin e katërt të studimeve, studentin e regjistrojë nëse ka akumuluar minimumi 30 ECTS kredi nga numri i përgjithshëm i kredive nga lëndët mësimore të vitit të tretë të studimeve.

Studenti, ka të drejtë të përsëritë regjistrimin e vitit të njëjtë të studimeve aq sa zgjatë dyfishi i kohës së studimeve. Numri maksimal i viteve të përsëritura nuk mund të tejkalojë numrin e viteve të rregullta të studimeve përkatëse. Më saktësisht shih nenin 145 të Statutit të UHZ-së. Studenti mund të kërkojë një herë që t'i vazhdohet edhe për një ose dy vite kohëzgjatja e studimeve të rregullta. Vendimin përfundimtar për këtë e merr Këshilli i fakultetit të njësisë akademike. Bazuar në nenin 146 të Statutit të UHZ-së, këshilli i fakultetit ka të drejtë të merr vendime të posaçme për vazhdimin edhe për një apo dy vite të statusit të studentit të rregullt.

NDRYSHIMI I STATUSIT TË STUDENTIT ME KORRESPONDENCË NË TË RREGULLT

Studentët që dëshirojnë të transferohen nga statusi me korrespondencë në studentë të rregullt dhe e kundërta, duhet të bëjnë kërkesë drejtuar dekanit të fakultetit. Transferim nga statusi i studentit me korrespondencë në studentë të rregullt do të i'u mundësohet vetëm atyre studentëve, të cilët kanë përfunduar vitin e parë ose vitin paraprak të studimeve në afatin e paraparë kohorë dhe kanë notë mesatare minimum 8.0. Studenti i cili është regjistruar në Fakultete të tjera, ka të drejtë të bëjë transfer në programet (drejtimet) përkatëse në njësi tjera akademike nëse i plotëson kushtet sipas nenit 34 të kësaj rregulloreje. Nëse kandidatit i lejohet kalimi në drejtimin përkatës atëherë ai/ajo është i obliguar që të paguaj tarifën përkatëse në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, për çdo provim të pranuar si dhe lejinin e kalimit, në llogari të Universitetit.

NDËRRIMI I DREJTIMIT TË STUDIMEVE

1. Studenti ka të drejtë të kërkojë ndërrimin e programit të studimeve në njësinë e njejtë apo në njësinë tjetër akademike të Universitetit.
2. Studentit i lejohet ndërrimi i programit, nëse së paku 50% të provimeve janë dhënë me sukses në programin e mëparshëm e që pranohen në programin e ri të studimeve.
3. Studentit mund t'i lejohet të regjistrohet në programin e ri të studimeve:
 - a. në vitin e dytë e tutje të studimeve në programe e drejtime përkatëse mësimore
4. Pëlqimin e jep Komisioni për studime, ndërsa vendimin e merr Këshilli i fakultetit.
5. Ndërrimi i programit të studimit nuk i lejohet studentit i cili duhet sërish të regjistrohet në vitin e parë të studimeve në programin e ri të studimeve.
6. Kërkesa për ndërrim të programit të studimeve apo drejtimit mësimor, i paraqitet komisionit për studime të fakultetit përkatës.
7. Krahas kërkesës, studentit paraqet edhe certifikatën e provimeve të dhëna të programit të mëparshëm.
8. Kundër vendimit të komisionit për studime, mund të paraqitet ankesë Këshillit të Fakultetit.
9. Ankesa paraqitet në afatin prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimit të komisionit.
10. Kur procedura e ndërrimit të drejtimit ka përfunduar, studentit nuk ka të drejtë të kthehet më në drejtimin e mëparshëm.

Transferet dhe ndërrimi i programit të studimit (afatet)

1. Gjatë ndërrimit të programit të studimit prej një universiteti tjetër në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë do të vlejnjë rregullat e njëjta si ato gjatë ndërrimit të programit të studimit brenda Universitetit.
2. Transfer/ ndërrimi i programit të studimit lejohet në kohën prej 1 deri më 15 shtator në semestrin dimëror, ndërsa prej 1 deri 15 shkurt për semestrin verorë.
3. Nëse kandidatit i lejohet kalimi në drejtimin përkatës atëherë ai-ajo është i obliguar që të paguaj tarifen përkatëse në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, për çdo provim të pranuar si dhe lejimin e kalimit, në llogari të Universitetit.

NDËRPRERJA DHE HUMBJA E STATUSIT STUDENT

Studenti i rregullt humb statusin për këto arsye:

- kur vendos të largohet nga studimet;
- kur i ka përfunduar studimet;
- kur dështon të regjistrohet në vitin akademik;
- kur nuk i ka përfunduar studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve;
- kur arrin numrin maksimal të regjistrimit të sërishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet;
- në rastin e përjashtimit, në bazë të vendimit të nxjerrë pas procedurës disiplinore.
- studentit mund të kërkojë një herë që t'i vazhdohet kohëzgjatja e studimeve për një (1) apo dy (2) vite. Vendimin e merr këshilli i njësisë akademike. Në rast se merret vendim pozitiv, studentit do ta ketë sërish statusin e studentit të rregullt.
- këshilli i njësisë akademike zbaton rregullat e posaçme për mbajtjen e statusit të studentit të rregullt në këto raste:
 - për të arriturat e veçanta në fushën e sportit, vërtetuar me status amator apo profesional në nivel rajonal apo më lart;
 - për të arriturat e veçanta si krijues artistik i njohur, vërtetuar me reagimin relevant të mediave dhe konfirmuar nga Këshilli i Fakultetit të Arteve;

- për personat me nevoja te veçanta, të vërtetuar me certifikatë të konziliumit mjekësor. Vendimi për regjistrim merret për çdo vit nga këshilli i njësisë akademike.

Suspendimi i statusit të studentit:

Studenti mund të kërkojë suspendim të përkohshëm nga statusi i studentit të rregullt në rastet e dëshmuara si të:

- sëmundjes së rëndë;
- kujdesi për fëmijët nën moshën tri (3) vjeçare;
- shtatzënisë dhe lehonisë;
- tjera të justifikuara. Vendimin përfundimtar e merr dekani i njësisë akademike.

Studenti mund të regjistrohet sërish si student i rregullt pa ndonjë pengesë në lidhje me periudhën e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të këtij Statuti. Periudha e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të këtij Statuti, nuk llogaritet në kohëzgjatje e studimeve.

Në qoftë se planprogrami valid në kohën e regjistrimit të parë të studentit nuk zhvillohet në vitin vijues të regjistrimit të studentit pas suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të këtij Statuti, komisioni i studimeve i njësisë akademike vendos për provimet diferenciale ose për obligimet tjera shtesë si kusht për vazhdimin e studimeve.

PËRFUNDIMI I STUDIMEVE DHE MBROJTJA E PROVIMIT PËRFUNDIMTAR (MBROJTJA E DIPLOMËS)

Në njësitë akademike të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, varësisht nga natyra e programit dhe akreditimi i tij, studimet themelore Bachelor përfundojnë pas përfundimit me sukses të të gjitha provimeve ose pas përfundimit me sukses të provimit përfundimtar, përkatësisht mbrojtjes së temës.

Studenti i nënshtrohet provimit përfundimtar pasit’i ketë përfunduar më parë me sukses të gjitha provimet e parapara në atë drejtim mësimor dhe pasi që ka grumbulluar së paku 180/230 kreditë nevojshme në emër të provimeve të dhëna, si dhe pasi të ketë kryer të gjitha obligimet tjera të parapara me Ligjin mbi Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit si dhe me Rregulloren për studimet themelore.

Mbrojtja e provimit përfundimtar (diplomës), është publike.

Mbrojtja e provimit përfundimtar bëhet para komisionit prej tre anëtarësh. Komisionin e cakton dekani në bashkëpunim me udhëheqësit e programeve mësimore.

Shënim me rëndësi:

Krahas kërkesës për paraqitjen e provimit përfundimtar, studenti paraqet edhe:

- ID kartelën,
- Fletëparaqitjen për provim përfundimtar (merret të referenti për çështje të studentëve),
- Punimin e diplomës (në pesë kopje)

Studimet Master në departamentet e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë përfundojnë me punimin dhe mbrojtjen e diplomës për master në pajtim me programet e studimeve.

TARIFAT E SHKOLLIMIT DHE PAGESAT ADMINISTRATIVE

Studentët shtetas të Republikës së Kosovës që fillojnë studimet në UHZ vitin e parë të studimeve e kanë falas.

Familjet kosovare që kanë më tepër se një student në universitete do të paguajnë vetëm për një student, ndërsa për studentët tjerë nuk do të paguajnë. Të gjithë fëmijët tjerë student të rinjë do të studiojnë pa pagesë.

- Pagesat për semestër për studentët e rregullt në nivelin Bachelor është 25 euro;
- Pagesat për semestër për studentët me korrespondencë është 125 euro;
- Pagesat për semestër për studimet Master-shkencor 150 euro;
- Pagesa për mbrojtjen e diplomës së studimeve Master-shkencor 100 euro;
- Pagesat për semestër për studimet Master-profesional 100 euro.

Pagesat administrative:

- Për provim pranues 2.5 euro;
- Për secalin provim plotësues për regjistrimin e studimeve Master 5 euro;
- Për provimin e studimeve Master 2.5 euro;
- Për certifikatë të notave 2.5 euro;
- Për certifikatë të diplomës 5 euro;
- Për diplomë 5 euro;
- Për diplomë duplikat 25 euro;
- Për ndërrim Fakulteti-Departamenti 25 euro.

KRITERETET PËR NDARJEN E BURSIVE

Për fitimin e bursës universitare studentët e studentët e studimeve bachelor dhe master duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë student të rregullt të Universitetit "Haxhi Zeka";
2. T'i kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve në afatin e shtatorit;
3. Të kenë notën mesatare në nivelin Bachelor së paku 9.00 (nëntë) ndërsa për studentët e Fakultetit të Artit 9.50 dhe në nivelin Master 9.50 (nëntë pikë pesëdhjetë);
4. Të mos kenë vit të përsëritur studimi.

LIRIMI NGA PEGESA E SEMESTRIT PËR STUDENTËT QË I TAKOJNË KATEGORIVE TË VEÇANTA

Duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-054 dhe Ligjin Nr.04/L-261, studentët që lirohen nga pagesa e semestrit janë si në vijim:

Lirohen me automatizëm nga pagesa e semestrave studentët që i takojnë kategorive si në vijim:

- a) Studentët e dy niveleve të studimeve që janë anëtar të ngushtë të familjeve të dëshmorëve, të zhdukurve dhe invalidëve të luftës së UÇK-së (ushtarak dhe civilë) neni 6, paragrafi 8, Ligji Nr.04/L-054;
- b) Studentët e dy niveleve të studimeve – veteranët luftëtarë dhe fëmijët e tyre (neni 31 Ligji Nr.04/L-261);

- c) Studentët e dy niveleve të studimeve që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës-familjar të viktimave civile të luftës 01.01.1998-12.06.1999);
- d) Studentët me nevoja të veçanta në dy nivelet e studimeve;
- e) Studentët e dy niveleve të studimeve, famiëjet e të cilëve janë në asistencë sociale.

I. Kategoria e studentëve si në paragrafin a), b) dhe c), me rastin e regjistrimit të semestrave të vitit akademik, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- a) Vërtetimin e noterizuar (me vulë origjinale të noterit) të lëshuar nga komisioni qendror për njohjen e statusit të kategorive që kanë dalë nga lufta;
- b) Certifikatën e lindjes së studentit dhe
- c) Certifikatën e bashkësisë familjare.

II. Kategoria e studentëve si në paragrafin d) dhe e), me rastin e regjistrimit të semestrave të vitit akademik duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- a) Vërtetimin e noterizuar (me vulë origjinale të noterit) të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe
- b) Certifikatën e bashkësisë familjare.

ORGANIZIMI I STUDENTËVE

Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore të cilave mund t'i përkasin të gjithë studentët.

Secila organizatë studentore ka statutin e vet që aprovohet nga anëtarët e saj në pajtim me rregulloret e përgjithshme të nxjerra nga Këshilli drejtues. Statuti do të përfshijë parimet për mundësi të barabarta dhe mosdiskriminim.

Interesat e studentëve do të përfaqësohen në kuadër të universitetit me këto organe:

- Parlamenti i studentëve në nivel të universitetit;
- Këshilli i studentëve në nivel të njësisë akademike.

Anëtarët për Parlamentin e studentëve dhe këshillat e studentëve do të zgjedhen në pajtim me procedurat për zgjedhje parlamentare.

Organizatave studentore kanë të drejtë të propozojnë anëtarët për parlamentin e studentëve dhe këshillin e studentëve të njësisë akademike në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në çdo dy (2) vjet.

Detajet për procedurën zgjedhore do të përcaktohen me rregullore të posaçme të nxjerra nga Këshilli drejtues në konsultim me Parlamentin e studentëve.

Limiti për nominimin e anëtarëve të organizatave studentore është:

- tre përqind (3%) i numrit të përgjithshëm të votave në nivel të njësisë përkatëse akademike për këshillat e studentëve të njësisë akademike;
- pesë përqind (5%) i numrit të përgjithshëm të votave për Parlamentin e studentëve.

Mandati i anëtarëve të Parlamentit të studentëve dhe këshillit të studentëve të njësisë akademike zgjat dy (2) vjet, pa te drejte te rizgjedhjes.

Parlamenti i studentëve dhe këshillat e studentëve të njësisë akademike ushtrojnë detyra në bazë të parimit të shumicës votave.

Parlamenti i studentëve është organi më i lartë i përfaqësimit të studentëve.

Numri i tërësishëm i anëtarëve të parlamentit të studentëve është nëntë (9).

Anëtarët propozohen nga organizatat studentore në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të arritura në zgjedhjet e studentëve dhe sipas listave prioritare të kandidatëve të publikuara nga secila organizatë studentore në fillim të fushatës zgjedhore.

Anëtarët e Parlamentit të studentëve zgjedhin kryetarin dhe nënkryetarin.

Këshilli drejtues nxjerr rregulloren e punës për Parlamentin e studentëve.

Parlamenti i studentëve zgjedh anëtarët e Senatit nga lista e të propozuarve e përgatitur nga këshilli i studentëve i njësisë akademike. Kryetari i Parlamentit të studentëve është anëtar ex – officio nga numri i përgjithshëm i anëtarëve studentë të Senatit.

Këshillat e studentëve janë organet e përfaqësimit të studentëve në secilën njësi akademike.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të secilit këshill të studentëve është një (1%) e numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt të regjistruar në atë njësi akademike, me më së paku pesë (5) dhe më së shumti njëzet e një (21) anëtarë.


Anëtarët do të propozohen nga organizata studentore në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të arritura gjatë zgjedhjeve të studentëve për secilën njësi akademike sipas listave prioritare të kandidatëve të publikuara nga organizata studentore në fillim të fushatës zgjedhore.

Anëtarët e secilit këshill të studentëve zgjedhin një kryetar dhe një nënkryetar.

Këshilli drejtues nxjerr rregulloren e punës për këshillat e studentëve.

Secili këshill i studentëve propozon listën me tre kandidatë për anëtarë studentë të Senatit për t'u zgjedhur nga Parlamenti i studentëve.

Këshilli i studentëve i secilës njësi akademike zgjedh anëtarët studentë të këshillit të njësisë akademike. Kryetari i këshillit të studentëve është anëtar ex- officio nga numri i përgjithshëm i anëtarëve studentë të këshillit të fakultetit.



TË DREJTAT DHE DETYRIMET E STUDENTËVE

Studentët që janë të pranuar në universitet kanë të drejtë:

- të marrin pjesë në të gjitha ligjëratat, seminarët dhe në mësimet e organizuara në lëndët e programit të zgjedhur të studimit sipas mbarëvajtjes së studimeve;
- të shfrytëzojnë bibliotekat universitare dhe shërbimet tjera për studentë;
- të marrin pjesë në zgjedhjet për përfaqësuesit studentë në organet universitare, të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe komisioneve ku janë të caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e tilla me angazhim dhe në mënyrë të sinqertë. Në rast të konfliktit të

interesit në lidhje me përmbajtjen, anëtarët e deleguar të studentëve nuk marrin pjesë në takime të organeve qeverisëse të universitetit;

- studentët gëzojnë të drejtën për të paraqitur ide të reja dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e statusit të studentit ose privilegjet që mund të gëzojnë nga universiteti;
- studentët kanë të drejtë të ankohen lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies ose për infrastrukturën e universitetit;
- studentët gëzojnë të drejtën për të kundërshtuar një vendim apo një veprim të universitetit ndaj tyre në Ministri dhe në gjykatën kompetente.

Studentët që janë të pranuar në universitet kanë detyrim:

- t'i respektojnë rregulloret e lëshuara nga universiteti;
- t'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;
- t'u kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
- të vijojnë ligjëratat në pajtim me rregullat e programit specifik të studimeve;
- të sillen mirë si në lokalet e universitetit ashtu edhe jashtë tyre për të mos e diskredituar universitetin;
- të respektojnë rregullat e kodit etik;
- të paguajnë pagesa dhe tarifa që janë të caktuara.

Studenti, i cili nuk i përmbahet detyrimeve ligjore, statusore, kodit të etikës si dhe rregullave dhe obligimeve të parapara me këtë rregullore apo me ndonjë vendim të veçantë të dekanit të fakultetit gjatë tërë kohës së studimeve, bënë shkelje të obligimeve të studimeve dhe për këtë përgjigjet në aspektin disiplinor dhe ligjor.

Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër çdo vendimi me të cilin konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre gjatë kohës së studimeve

Ankesa paraqitet:

- Këshillit të fakultetit - kundër vendimit të dekanit, kur ai ka vendosur si organ i shkallës së parë,
- Komisionit për Ankesa - kundër vendimit të Komisionit për Studime, kur ka vendosur si organi i shkallës së parë të fakultetit,
- Komisionit për studime të Universitetit - kundër vendimit të Këshillit të Fakultetit, kur ka vendosur si organ i shkallës së parë.

Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marrë prej organeve të universitetit, të njësive akademike dhe njësive organizative që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e tyre.

2. Ankesat e tilla i dorëzohen komisionit të studimeve të njësisë akademike brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.

3. Komisioni i studimeve është i obliguar t'ia dorëzojë raportin për vendimin e marrë këshillit të njësisë akademike brenda tridhjetë (30) ditëve të punës pas pranimit të ankesës.

4. Ankesa rreth vendimit në shkallë të dytë vendoset nga Senati.

5. Studentët kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin e Senatit në gjykatën kompetente.

SHËRBIMET E STUDENTËVE

Si student i ri do të kesh nevojë për informacionet themelore për aplikimin, regjistrimin, procesin mësimor e për procedurat e tjera për statusin tënd si student. Për këtë gjithmonë përkujdeset Shërbimi i Studentëve. Të vendosur në secilën njësi akademike zyrtarët për çështje studentore, gjithnjë janë të gatshëm të ju dalin në ndihmë për çdo kërkesë apo pyetje për të cilën do të keni nevojë për sqarime. Shërbimi i studentëve është në dispozicionin tuaj nga e hëna deri të premtën në orar të plotë edhe atë duke filluar në orën 08.00 në mëngjes dhe deri në orën 16:00.

Çështjet administrative të cilat i kryen Shërbimi i Studentëve:

- Provimet pranuese;
- Regjistrimi i semestrit;
- Paraqitja e provimeve;
- Vërtetimet për studime;
- Certifikatat për provimet e dhëna;
- Parashtrimi i kërkesave për bartjen e provimeve në raste transferim;
- Përgatitja e dosjes së studentëve me rastin e diplomimit;
- Lëshimi i certifikatës së diplomimit dhe të notave për studentët e diplomuar.

E-kiosk është një pajisje ku mund studentë mund të hyjnë në webfaqe të Universitetit dhe mund të informohen për lajmet, ngjarjet dhe të gjitha informatat lidhur me Universitetin. E-Kiosk studentëve ju mundëson të hyjnë në Sistemin Elektronik për Menaxhim të Studentëve (SEMS) dhe mund t'i regjistrojnë lëndët obligative dhe zgjedhore, mund të paraqesim provimet, të shikojnë rezultatet dhe të i shikojnë të gjitha materialet të cilat ju ofrohen në SEMS, poashtu E-kiosk studentëve ju mundëson parashtrimin e ankesave në formë anonime dhe jo anonime.

QENDRA PËR ZHVILLIM TË KARRIERËS

Misioni i Qendrës për Zhvillim të Karrierës (QZHK) është të udhëzojë studentët përmes procesit të zbulimit arsimor, karrierës dhe zbulimit personal në përgatitjen e tyre për sukses në fuqinë globale të punës.

Qëllimet e Qendrës për Zhvillim të Karrierës (QZHK) janë:

- Të fuqizojë studentët të zgjedhin arsimimin dhe karrierën e tyre profesionale duke theksuar aftësitë, vlerat, besimin dhe qëllimin e tyre;
- Të udhëzojë studentët për përgatitjen e CV-së, letrën e motivimit dhe përgatitjen e intervistës;
- Të sigurojë mundësi për punë praktike;
- Të sigurojë trajnime për të zhvilluar aftësitë e nevojshme për të kërkuar punë;
- Të organizojë punëtori, seminare, tryeza të rrumbullakëta, konferenca, biseda dhe prezantime të punëdhënësve në mënyrë që studentët të mund të kuptojnë më mirë botën e punës dhe të zotërojnë aftësitë e nevojshme për një organizim dhe planifikim të suksesshëm të karrierave personale;
- Ofrimi i shërbimeve për kompanitë si prezantim i ofertave të tyre të punës për të diplomuarit dhe biseda me këta ofertues;
- Mundëson komunikim me punëdhënësit e mundshëm;
- Ofrimi i ndihmës zhvillimore për idetë e studentëve;
- Inkurajoni studentët të eksplorojnë fusha të ndryshme profesionale dhe të ndjekin një karrierë bazuar në aftësinë e individit, si dhe potencialin e tregut;
- Sigurimi i mbështetjes së komunitetit duke përfshirë studentët në projekte të ndryshme, promovimin e përdorimit të objekteve shkollore dhe ofrimin e projekteve konkrete në të mirë të të gjithë qytetarëve të vendit.

Këshillimi për karrierë

- Si të përgatisni një CV të synuar?
- Si të përgatisni një Letër Motivimi?
- Trajnimi i Intervistës për Punë tallje
- Përgatitja e duhur e profilit të LinkedIn
- Hyrje në shkrimin e aplikacioneve të duhura për punë

Puna praktike: Përvojë në lidhje me karrierën gjatë verës ose semestrit.

Vizitat në biznese/institucione: Udhëtime të gjata ditore për të eksploruar një ditë pune në organizata të ndryshme. Studentët janë në gjendje të vizitojnë një kompani, të takojnë punonjësit dhe të bëjnë ndonjë pyetje se çfarë është në të vërtetë si të punosh në industri.



Panairet e Karrierës: Ngjarjet që sjellin punëdhënësit dhe studentët së bashku, në mënyrë që punëdhënësit të mund të ndajnë informacione rreth mundësive të punësimit ndërsa studentët mund të bashkohen me profesionistë të fushës dhe mund të marrin një intervistë për një pozicion.



Sesione të informimit: Punëdhënësit vizitojnë kampusin për të dhënë prezantime të shkurtra se kush janë ata dhe çfarë bëjnë, ndërsa studentët njoftohen për mundësi specifike dhe bashkëveprojnë një në një me përfaqësuesit.



Ditët promovuese - Çdo vit në Shkollat e Mesme Rajonale të Pejës, personeli i Qendrës për Zhvillim të Karrierës në bashkëpunim me Shoqatën Alumni dhe Parlamentin Studentor mban ditë promovuese për të informuar nxënësit për programet e studimit universitar dhe mundësitë e mëvonshme të karrierës, si dhe mbështetjen e ofruar për studentët që të angazhohen në praktikë, punësim sezonal dhe të marrin pjesë në leksione, debate dhe punëtori të ndryshme të organizuara nga QZHK.



Ditët e informimit: Pas hapjes së afatit të aplikimit, mbahen ditë informative ku gjatë gjithë kohës që është hapur konkursi, personave të interesuar u ofrohet ndihmë për aplikim dhe shpjegime të tjera për të cilat ata janë të interesuar.



Java e Mirëseardhjes: Qëllimi i këtij organizimi është që brucoshët të informohen për historikun e UHZ-së dhe mundësitë që ata do të kenë për fitimin e njohurive të nevojshme për zhvillimin e suksesshëm të karrierës së tyre.



BIBLIOTEKA

Fakulteti Juridik, Kati III
Biblioteka posedon 2839 libra

Fakulteti i Biznesit, Ndërtesa B, Kati II
Biblioteka posedon 3754 libra

Biblioteka EBSCO:
Kyqja: UNIVERSITETI I PEJËS

Shkoni në:
<http://search.ebscohost.com>
Id e përdoruesit: ns020570
Fjalëkalimi: Fjalëkalimi



Qasja në EBSCO mund të bëhet vetëm brenda kampusit të Universitetit "Haxhi Zeka"-Pejë.

Biblioteka Kombëtare e Kosovës ofron shërbim të referencave për studentët, stafin akademik dhe administrativ të UHZ-së, duke përfshirë këtu edhe informacionin për koleksionet e BKK-së, katalogun elektronik dhe manual, mënyrat e hulumtimit, mënyrat e huazimit, etj.

BKK u ofron shërbim studentëve dhe stafit akademik të UHZ-së, edhe në burimet elektronike në të cilat BKK ka abonim.

LABORATORËT



KABINETET E INFORMATIKËS

